

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË FUSHË KRUIJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Fushë Krujë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2013 deri më datë 31.03.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 64, datë 29.05.2015.

Bazuar në nenet mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 268/8, datë 29.05.2015, i ka rekomanduar z. Gjon Bardhi, Kryetar i Bashkisë Fushë Krujë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se nuk janë ndërmarrë veprimet e plota të nevojshme për realizimin dhe zbatimin e tyre, duke lejuar që 7 (shtatë) rekomandime të mbeten pa zbatuar nga të cilat 1 (një) masë organizative, 5 masa shpërblymjeje në vlerën 3,407,141 lekë dhe 1 (një) masë gjobe në vlerën 100,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”.

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë të marrë të gjitha masat, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për realizimin e të gjitha detyrave të lëna në auditimet e mëparshme dhe arkëtimin e detyrimeve nga pesë subjekte në vlerën 3,407,141 lekë dhe 1 (një) masë gjobe në vlerën 100,000 lekë.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në periudhën objekt auditimi, hartimi, miratimi dhe zbatimi i buxhetit është kryer tej afateve ligjore të përcaktuara me kërkesat e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara në kërkesat e nenit 19, pika 4 dhe 5 “*Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore*”, nenin 32 “*Përgatitja dhe miratimi i buxhetit vendor*” të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”.

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë të marrë të gjitha masat për hartimin në kohë e me cilësi të projekt buxhetit vendor dhe miratimin e tij në Këshillin e Bashkisë brenda afateve ligjore.

Vazhdimisht

3. Gjetje nga auditimi: Në hartimin dhe miratimin e buxhetit nuk janë përllogaritur detyrimet afatshkurtra të Bashkisë ndaj të tretëve për vitin 2014 në vlerën 176,145,417 lekë dhe detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë për vitin 2014 në vlerën 257,912,730 lekë .

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë të marrë të gjitha masat për reflektimin në hartimin dhe miratimin e buxhetit të detyrimeve afatshkurtra të Bashkisë ndaj të tretëve si dhe detyrimet e të tretëve ndaj Bashkisë, duke kryer të gjitha regjistrimet e ndryshme në kontabilitet.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Shërbimit Social, pranë Bashkisë, në disa raste të përgatitjes të dokumentacionit të ndihmës ekonomike ka rezultuar se Projekt Vendimet dhe Vendimet e Ndihmës Ekonomike janë hartuar dhe miratuar pas datës 25 të muajit përkatës, veprim në kundërshtim me pikën 14, dhe 15 Kreu XI të Udhëzimit nr.338/3, datë 10.03.2006 .

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimit Social në Bashki, për dhënien e ndihmës ekonomike, të kompletojë të gjitha dosjet me dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe pas përputhjes së dokumentacionit të hartohen Projekt Vendimet brenda datës 15-25 të çdo muaji, si dhe të miratojë në Këshillin e Bashkisë Vendimet e Ndihmës Ekonomike brenda çdo muaji.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi: Pasqyrat financiare vjetore që shoqërojnë bilancet kontabël të viteve 2013 dhe 2014 janë të rakorduara me tepricat e llogarive respektive të pasqyruara në llogaritë sintetike të aktivitetit dhe të pasivitetit të cilat në auditimin e ushtruar për saktësinë e tyre u gjetën të rakorduara sipas

klasave, aktive të qëndrueshme, aktivet qarkulluese dhe detyrimet. Është pasqyruar në kontabilitet, rritja e aktiveve të qëndrueshme dhe të aktiveve qarkulluese. Për debi-kreditë të gjitha veprimet janë kryer sipas analizave (subjekteve dhe personave) dhe tepricat e llogarive sintetike, janë të njëjta me ato të llogarive analitike .

Rekomandim: Në zbatim të planit strategjik dhe objektivave të përcaktuara në deklaratën e vizionit dhe të misionit të Bashkisë Fushë - Krujë, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtoritë e tjera të Bashkisë në vazhdimësi, të organizojnë punën për uljen në maksimumin më të mundshëm të numrit dhe vlerave të debitorëve, të cilët në fund të vitit 2014 arrijnë në 100,787,246 lekë dhe të kreditorëve, të cilët në fund të vitit 2014 arrijnë në vlerën 63,139,384 lekë.

Vazhdimisht

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit të blerjeve në vlera të vogla, konstatohet se në disa raste dokumentimi dhe evidentimi i ngjarjeve dhe veprimeve ekonomike është realizuar mbas realizimit të tyre, nuk ka rrjedhë kronologjike, por ka kapërcime në kohë të veprimeve, pasi procesverbali i komisionit të blerjeve në vlera të vogla, fatura tatimore dhe fletë-hyrja nuk korrespondojnë me datën e marrjes në dorëzim të mallit apo shërbimit, veprim në pajtueshmëri me përputhjen dhe rregullshmërinë financiare dhe në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarte të auditit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë”, Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

Rekomandim: Komisioni i kryerjes së blerjeve dhe shërbimeve në vlera të vogla në të gjitha rastet në dokumentimin e tyre, të zbatojë rrjedhën kronologjike të kryerjes së veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike, sipas kërkesave ligjore dhe në pajtueshmëri me përputhjen dhe rregullshmërinë financiare.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2013 dhe 2014, pranë Bashkisë Fushë-Krujë janë depozituar për ekzekutim Vendime Gjyqësore të formës së prerë nga 5 ish-punonjësit të administratës së kësaj bashkie. Sipas arsytimit të këtyre vendimeve, të pesë këta punonjës janë larguar padrejtësisht nga puna, e për pasojë Bashkia Fushë-Krujë i detyrohet këtyre punonjësve të paguaj nga fondet e bashkisë vlerën totale 3,691,892 lekë, nga e cila dëmshpërblim page për 5 ish punonjës në vlerën 3,346,912 lekë, shpenzimet gjyqësore në vlerën 192,012 lekë dhe shpenzimet e përmbaramit privat në vlerën 152,968 lekë. Veprimet e largimit në mënyrë të padrejtë nga puna të këtyre punonjësve bien në kundërshtim me nenet 143, e në vijim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenet 126, 306 -310 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo shkelje ka sjellë një përdorim negativ të fondeve të Bashkisë në vlerën **3,691,892 lekë** .

Rekomandim: Për çdo rast, vendimet gjyqësore të formës së prerë të ekzekutohen vullnetarisht për të eliminuar shpenzimet e përmbaramit, si dhe të analizohen, duke nxjerrë shkaqet, arsyet dhe përgjegjësinë e personave konkretë që kanë sjellë këtë pasojë negative.

Vazhdimisht

8. Gjetje: Në 10 procedura u konstatuan shkelje të rregullave të prokurimit publik. Këto shkelje kryesisht kanë konsistuar në skualifikime të operatoreve ekonomikë në kundërshtim me këto rregulla dhe në vendosjen në kriteret të veçanta të paraqitjes së analizave teknike të çmimeve në fazën e shqyrtimit teknik të ofertave, kërkesë kjo e vendosur në mënyrë të paargumentuar dhe pa e mbështetur në ligj, çka i ka lejuar KVO-së, të ketë hapësira që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të skualifikojë në mënyrë subjektive disa operatorë, pikërisht për shkak të mosplotësimit të kësaj kërkesë, ndërkohë që disa nga këta operatorë kanë pasur ofertat më të ulëta në vlerë se fituesit. Nga këto veprime, përveçse janë krijuar kushte jo të barabarta dhe diskriminuese të operatorëve ekonomik, në gjashtë prej tyre, u konstatua se nuk janë kursyer nga buxheti i bashkisë fonde në vlerën **2,532,949 lekë**. Konkretisht shkeljet janë konstatuar në këto procedura:

-Në procedurën “Sistemim-asfaltim i rrugës së fshatit Zallë” , me fond limit 3,443,206 lekë nuk janë kursyer 402,078 lekë.

-Në procedurën “Sistemim-asfaltim i rrugës së Senevë, Arrameras” me fond limit 3,768,323 lekë, nuk janë kursyer 502,293 lekë

- Në procedurën “Sistemim-asfaltim i rrugës së fshatit Halil ” me fond limit 3,261,863 lekë, nuk janë kursyer 216,669 lekë.
- Në procedurën “Ndërtim KUZ lagje Dibranëve, Kameras” me fond limit 2,691,757 lekë, nuk janë kursyer 317,521 lekë.
- Në procedurën “Sistemim-asfaltim i rrugës së Vinjollëve e Danëve” me fond limit 4,340,942 lekë nuk janë kursyer 1,088,079 lekë.
- Në procedurën “Shtrim me beton i rrugës Ali Halili,” me fond limit 1,106,954 lekë, nuk janë kursyer 6,309 lekë.
- Në procedurën “Shtrim me beton i rrugës së Bruzëve,” me fond limit 945,342 lekë.
- Në procedurën “Punime riparimi e lyerje shkollash” me fond limit 999,994 lekë.
- Në procedurën “Blerje karburanti naftë D1” me fond limit 1,083,333 lekë.
- Në procedurën “Ndërtimi i shkollës së mesme “Shote Galica” Fushë Krujë” me fond limit 139,836,446 lekë.

Rekomandim: Bashkia Fushë-Krujë në çdo procedurë prokurimi, në vendosjen e kërkesave të veçanta të përcaktojnë kriteret në përpjesëtim me vlerën e kontratës të ulët, të cilat të jenë të lidhura ngusht me objektin e kontratës dhe të argumentuara teknikisht dhe ligjërisht.

Vazhdimisht

9. Gjetje: Në procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i rrugës së Durrësit”, me fond limit 111,704,062 lekë, nga tetë operatore pjesëmarrës janë skualifikuar shtatë operatorë, nga të cilët gjashtë kishin ofertat ekonomike më të ulëta se operatori i kualifikuar me diferencë që shkon nga 3,537,564 lekë në 17,004,967 lekë. Skualifikimi i këtyre operatorëve, është bërë vetëm me dy vota të anëtarëve të komisionit, ndërsa Kryetari i Komisionit ka votuar pro kualifikimit të tyre. Nga këto veprime apo mosveprime nuk është përmbushur qëllimi i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” në lidhje me mirë përdorimin e fondeve pasi nuk i janë kursyer Buxhetit të Bashkisë fonde në vlerën **17,004,967 lekë**. Mirëpo këtë efekt ekonomik negativ për buxhetin e bashkisë e ka rikuperuar Komisioni i Prokurimit Publik, i cili me vendimin nr. 459/1, datë 07.08.2014, ka urdhëruar Autoritetin Kontraktor të korigjojë veprimet e kryera dhe të kualifikojë e të shpallë fitues BO “BAMI &Curri” të s`kualifikuar nga KVO.

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë në çdo procedurë prokurimi, në rastet kur konstatohen mangësi në dokumentacionin teknik të operatorëve pjesëmarrës, ti kërkojë këtyre operatorëve sqarime për mangësitë e konstatuara, për të shqyrtuar dhe krahasuar ofertat e tyre sa më drejtë në raport me ofertat e tjera.

Vazhdimisht

10. Gjetje: Autoriteti Kontraktor në kundërshtim me ligjin nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe me VKM nr.1, datë 01.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, ka vendosur që tenderi i “Pastrimit të qytetit Fushë-Krujë”, si në vitin 2013 dhe në vitin 2014 të jepet me sipërmarrje private, me afat kohor 1 (një) vjeçar. Ky veprim ndikon negativisht në rritje të kostos së shërbimit, në dëm të buxhetit të bashkisë. Nga kjo sipërmarrësi i shërbimit nuk mund të rikuperojë me fitimin e një viti, koston e investimit të nevojshëm, që do të kryhej për shërbimin e pastrimit, si blerjen e makinerive teknologjike, të kazanëve, koshave, etj. Për pasojë mos kryerja e investimeve nga ana e sipërmarrësit, përveç rritjes së kostos së shërbimit nga viti në vit, ndikon negativisht edhe në performacën e këtij shërbimi, në dëm të mbrojtjes e mjedisit urban dhe të shëndetit të popullatës, të cilët janë edhe taksapaguesit kryesor që mbulojnë shpenzimet e pastrimit të qytetit .

Rekomandim: Në përfundim të afatit kohor të kontratës, tenderi i pastrimit të qytetit të prokurohet me afate kohore mbi një vit, në zbatim të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave” dhe VKM nr.1, datë 01.01.2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”.

Me përfundimin e kontratës ekzistuese

11. Gjetje: Autoriteti Kontraktor në procedurat e prokurimit për “Blerje karburanti naftë D1” me fond limit 833,333 lekë për vitin 2013 dhe me fond limit 1,083,333 lekë për vitin 2014, ka vepruar në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse nuk ka mbajtur dokumentacion për të argumentuar dhe shpjeguar se ç`farë çmimi është marrë parasysh për llogaritjen e vlerës limit të

kontratës së karburantit. Nuk është shprehur me procesverbal apo dokument tjetër se çmimet e karburantit cilës periudhë (buletini) i janë referuar operatorët pjesëmarrës për llogaritjen e marzhit të fitimit, apo vetë KVO, çmimet e cilit buletin ka marrë për bazë, për të bërë vlerësimin dhe saktësimin e llogaritjes së marzhit të fitimit të operatorit fitues. Po kështu, për të dy vitet sasia e karburantit është tërhequr me tollona menjëherë që me lidhjen e kontratave si dhe është likuiduar në total e gjithë vlera e kontratave. Tërheqja dhe likuidimi i gjithë sasisë së karburantit, që me lidhjen e kontratës të pashoqëruara me të dhënat të botuara në buletin e APP-së, e bëjnë të pa mundur kontrollin e përqindjes, së rritjes apo të uljes së çmimit të bursës, sipas Reuters, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri dhe kontrollin e cilësisë së mallit të livruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë, siç përcaktojnë rregullat e prokurimit publik.

Rekomandim : Bashkia Fushë-Krujë, në shpërndarjen e fondit limit për blerje karburanti, të marrë parasysh të dhënat e botuara në buletin e APP-së, të marra nga bursa Reuters për të llogaritur fondin limit.

Vazhdimisht

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë të vlerësoj ofertat e operatorëve në bazë të çmimeve të botuara në buletin e fundit të APP-së, para hapjes së ofertave, të marra nga bursa Reuters.

Vazhdimisht

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë gjatë zbatimit të kontratës për furnizimin me karburant para pagimit të faturës, të kontrollojë rritjen apo uljen e çmimit të bursës sipas buletinit të APP-së, si dhe të kontrollohet cilësia e mallit të lëvruar, nëse është e njëjtë me atë të premtuar në ofertë.

Vazhdimisht

12. Gjetje: Autoriteti Kontraktor, procedurën e prokurimit “Mbikëqyrje e punimeve të ndërtim të shkollës së mesme Shote Galica Fushë Krujë” me fond limit 1,522,259 lekë, e ka zhvilluar me “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës”. Përzgjedhja e kësaj procedure është argumentuar me arsyen e mbrojtjes së të drejtës ekskluzive të autorit dhe është në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik, sepse kontratat e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve të ndërtimit, janë kontrata shërbimi të cilat janë shumë të mirënjohura në tregun vendas dhe nuk kanë të bëjnë me të drejtën ekskluzive të autorit. Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit sipas legjislacionit në fuqi kryhet nga profesionist të cilët licencohen për ushtrimin e këtij aktiviteti dhe asnjë nga këta nuk gëzon të drejtën ekskluzive mbi këtë shërbim.

- Nga data 01.01.2013 deri në datën 06.06.2014, edhe pse ekzistonte baza ligjore në fuqi, Bashkia nuk ka pasur tagër administrativ dhe hapësirë të mjaftueshme për shqyrtim dhe miratim të kërkesave të ndryshme për leje ndërtimi, përveç rasteve përjashtimore të përcaktuara në ligj, të cilat nuk i pengonte mungesa e IPV, dhe këto tepër të kufizuara, vetëm për shtëpi banimi.

- Të gjitha dosjet e lejeve të zhvillimit dhe lejeve të përdorimit para dhe mbas periudhës së auditimit nuk ishin të inventarizuara dhe dorëzuara në arkivin e Bashkisë sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, por mbaheshin në zyrat e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Rekomandim: Të gjitha dosjet e lejeve të zhvillimit dhe lejeve të përdorimit të inventarizohen dhe të dorëzohen në arshivën e Bashkisë.

Brenda muajit Korrik 2015

13. Gjetje: Për vitin 2013, janë marrë 14 (katërmëdhjetë) vendime për dënim me gjobë në vlerën 12,130,000 lekë për ndërtimet pa leje. Për arkëtimin e gjobave inspektoriati ka kërkuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, nxjerrjen e titujve ekzekutiv për një pjesë të tyre në vlerën **10,500,000 lekë**, por deri në momentin e auditimit kjo vlerë ende nuk është arkëtuar në llogarinë e Bashkisë. Për vitin 2014 janë marrë 13 vendime për dënime me gjobë për ndërtimet pa leje në vlerë totale 2,930,000 lekë. Për arkëtimin e tyre inspektorati nuk ka kërkuar në gjykatë nxjerrjen e titujve ekzekutiv, por kërkesa për arkëtim është bërë nëpërmjet vetë bashkisë dhe deri në momentin e auditimit janë arkëtuar vetëm 350,000 lekë.

Rekomandim: Të merren masa dhe të ndiqet në rrugë gjyqësore dhe administrative arkëtimi i vlerave të gjobave nga kundërvajtësit.

14. Gjetje: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor nuk disponon të dhëna të përditësuara në vite dhe një numër të përgjithshëm të ndërtimeve pa leje të bëra në juridiksionin territorial të kësaj Bashkie, por disponon vetëm të dhëna operative për ndërtimet që janë kryer rishtas për vitin 2013 dhe 2014.

Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes dhe Kontrollit të Territorit Vendor të kryej verifikimin e të gjitha ndërtimeve pa leje të bëra në juridiksionin territorial të Bashkisë dhe të mbajë të dhëna të përditësuara për to, duke zbatuar sanksionet ligjore.

Brenda muajit Qershor 2015

15. Gjetje: Në përbërje të strukturës organizative të Bashkisë nuk është ngritur dhe nuk funksionon Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve. Mos ngritja dhe mos funksionimi i këtij sektorit është në kundërshtim me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 15, datë 30.06.2003 të Ministrisë së Pushtetit Vendor e Decentralizimit.

Rekomandim: Në strukturën organizative të Bashkisë Fushë-Krujë, apo strukturës së re që do të krijohet në kuadrin e reformimit të njësive të qeverisjes vendore, të ngrihet dhe të funksionoi Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve në përputhje me, VKM-në nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme”

Brenda muajit Shtator 2015

16. Gjetje: Bashkia Fushë-Krujë nuk ka krijuar një regjistër elektronik, apo manual dhe nuk ka bërë regjistrimin e të gjitha pronave me të gjitha të dhënat tekniko-ligjore, në kundërshtim me nenin 21 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme”.

Rekomandim: Të krijohet regjistri elektronik apo manual dhe të bëhet regjistrimi i të gjitha pronave me të gjitha të dhënat tekniko-ligjore në këtë regjistër, në përputhje me VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe transferimin e pronave të paluajtshme”.

Brenda muajit Dhjetor 2015

17. Gjetje: Në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, dhe në zbatim të VKM nr. 1264, datë 17.09.2008, për një pjesë të pronave janë hartuar plan-rilevime dhe janë paraqitur brenda afateve ligjore për regjistrim në ZVRPP Krujë. Po kështu në zbatim të VKM nr. 108, datë 03.02.2008, janë hartuar plan-rilevimet e të gjitha pronave pyje dhe kullota që janë depozituar për regjistrim në ZVRPP Krujë. Edhe pse janë kryer aplikimet për një pjesë të mirë të pronave, nuk është gjetur bashkëpunimi i duhur me ZVRPP Krujë, për regjistrimin e pronave, pasi nga 1040 prona shtetërore, pyje e kullota, janë regjistruar vetëm 9 prona shtetërore.

Rekomandim: Bashkia Fushë Krujë, t'i kërkoj Ministrisë së Drejtësisë që të ndërhyjë pranë ZRPP, Tiranë dhe ZVRPP Krujë për të mundësuar regjistrimin e pronave të transferuara kësaj njësie të qeverisjes vendore.

Brenda muajit Dhjetor 2015

18. Gjetje: Nisur nga mungesa e një strukture të posaçme për menaxhimin e pronave si dhe duke parë vonesat e stërgjatura të regjistrimit të pronave nga ZVRPP Krujë, bashkia duhet të ngrinte grupe pune dhe të bashkëpunonte me institucionet, që kanë pasur këto prona në inventar, për të mundësuar, mbledhjen e dokumentacionit, me qëllim vlerësimin dhe inventarizimin paraprak dhe regjistrimin në kontabilitetin e Bashkisë të pronave të transferuara, në zbatim të pikës 22 të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”.

Rekomandim: Të ngrihen grupe pune për të plotësuar me dokumentacionin e mjaftueshëm e të nevojshëm pronat e transferuara nga institucionet që i kanë pasur në inventar ato me qëllim vlerësimin paraprak të tyre dhe regjistrimet në kontabilitet.

Brenda muajit Dhjetor 2015

19. Gjetje: U vërejtën paqartësi të sipërfaqeve të përcaktuara në certifikatat e pronësisë apo vërtetimet hipotekore të lëshuara nga ZVRPP Krujë, pasi në to janë përcaktuar vetëm sipërfaqja

ndërtimore e katit të parë dhe nuk përcaktohej e gjithë sipërfaqja e ndërtimit të objektit, për pasojë nuk përputheshin me sipërfaqet e përcaktuara në kontratat respektive. Kjo paqartësi bënë të pamundur vlerësimin, nëse e gjithë sipërfaqja e marrë me qira është regjistruar në ZVRPP, si dhe e gjithë sipërfaqja e marrë me qira sipas kontratave shfrytëzohet realisht për mësim dhënie.

Rekomandim: Të ngrihet komision për të bërë azhurnimin e sipërfaqeve të përcaktuara në ofertat dhe në kontratat me sipërfaqet që shfrytëzohen faktikisht për mësim dhënie.

Brenda muajit Dhjetor 2015

20.Gjetje: Gjatë vitit 2013 nga policia bashkiake për shkelje të ndryshme janë mbajtur 12 procesverbale gjobe me vlerë 11.500 lekë për kundërvajtje të rregullave të qarkullimit të automjeteve, vlerë e cila nuk është arkëtuar nga kundërvajtësit.

- Gjatë vitit 2014 nga policia Bashkiake për shkelje të ndryshme janë mbajtur 7 procesverbale gjobe me vlerë 4.000 lekë, nga të cila është arkëtuar vetëm vlera 2,000 lekë.

Rekomandim: Policia Bashkiake në bashkëpunim me sektorët dhe Drejtoritë e tjera të Bashkisë, të marrë të gjitha masat për arkëtimin e gjobave të vendosura dhe të pa arkëtuara, duke kërkuar vendosjen e barrës sigurorese dhe bllokimin e llogarive bankare ndaj subjekteve debitore në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, bankat e nivelit të dytë, Drejtorinë Rajonale të Transportit Durrës, Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë.

Brenda muajit Korrik 2015

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Fushë- Krujë të marrë masat, për të kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **2,445,728 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera, në të gjitha shkallët e gjykimit, konkretisht:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në dokumentimin e blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla në magazinë rezulton se në 7 (shtatë) raste për subjektet sipërmarrëse nuk është marrë parasysh zbatimi i kushteve të kontratës në afatin e dorëzimit të mallit apo shërbimit mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 26.11.2006 “*Për prokurimin publik*” me ndryshime, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës, neni 23 “*Likuidimi i dëmeve për dorëzimin e vonuar*” pika 23.1 germa “a” duke mos aplikuar sanksionet dhe penalitetet si pasojë e dorëzimit me vonesë nga kushtet e kontratës në vlerën **296,623 lekë**.

Rekomandim: Drejtoria e Financës të arkëtojë detyrimin në vlerën **296,623 lekë** nga 7 (shtatë) subjektet, si penalitet i llogaritur për pasojë të dorëzimit me vonesë të mallit dhe shërbimit nga kushtet e kontratës,

Brenda muajit Korrik 2015

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në dokumentimin e pagesave me bankë për Albtelekomin rezulton se në 16 raste për shtatë zyrat e Bashkisë, shpenzimet për telefoninë fikse, nuk janë paguar në afatin e duhur dhe për rrjedhojë nga Albtelekomi janë aplikuar kamatëvonesa në vlerën **9,050 lekë** e cila përbën dëm ekonomik.

Rekomandim: Zj.Xh. Xh me detyrë Drejtore e Financës, të arkëtojë detyrimin në vlerën **9,050 lekë**, pasi ka paguar kamatëvonesa për shpenzimet e telefonisë fikse për shtatë zyrat e administratës të pa justifikuar për llogari të Albtelekomit.

Menjëherë

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje në dokumentimin e pagesave me bankë me urdhër shpenzimin nr. 83, datë 20.02.2015 për llogari të subjektit “M....” është paguar më tepër vlera 11,046 lekë për objektin “*Shtrim me beton rruga e fshatit Halil*” fatura nr.113, datë 31.01.2015 për punime të kryera nga data 26.12.2014 deri më datë 17.01.2015 në situacionin e punimeve zëri 6 “*gërmim dheu*” sasia 26,25 m3 ndërsa zëri 7 “*transport dheu distanca deri 5 km*” situacionuar 68,25 m3 ose 42 m3 më shumë x 263 lekë = **11,046 lekë** paguar më tepër, e cila përbën dëm ekonomik.

Rekomandim: Drejtoria e Financës të arkëtojë detyrimin në vlerën **11,046 lekë** nga operatori ekonomik “M....” pasi ka përfutur më tepër për punime të pa kryera.

Brenda muajit Korrik 2015

4. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve në tenderin me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugës së fshatit Zallë*”, u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria “V...”, për punë të pakryer, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **264,024** lekë.

Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia, duke i kërkuar operatorit ekonomik “V.....”, arkëtimin e shumës 264,024 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugës së fshatit Zallë*”.

Brenda muajit Korrik 2015

5. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve në tenderin me objekt “*Zgjerimi e Rikonstruksioni i rrugës Larushk i Poshtëm + Sistemim-Asfaltim Lagje Lata, Loci, Zogu e Luka*” u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria “Gandhi Construcion”, për punë të pakryer, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **1,725,635** lekë.

Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia, duke i kërkuar operatorit ekonomik “G.....Const”, arkëtimin e shumës 1,725,635 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “*Zgjerimi e Rikonstruksioni i rrugës Larushk i Poshtëm + Sistemim-Asfaltim Lagje Lata, Loci, Zogu e Luka*”.

Brenda muajit Korrik 2015

6. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve në tenderin me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugës së Çamit, Myftarit dhe Avdi Zirit*” u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria “V.....”, për punë të pakryer, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **67,586** lekë .

Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia, duke i kërkuar operatorit ekonomik “V.....”, arkëtimin e shumës 67,586 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugës së Çamit, Myftarit dhe Avdi Zirit*”.

Brenda muajit Korrik 2015

7. Gjetje nga auditimi: Në zbatimin e punimeve në tenderin me objekt “*Shtrim me beton i rrugës Ali Halili, fshati Halil*” u konstatuan diferenca në zëra dhe volume duke përfituar padrejtësisht shoqëria “M....”, për punë të pakryer, duke shkaktuar një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë në vlerën **71,764** lekë .

Rekomandim: Të merren masa nga Bashkia, duke i kërkuar operatorit ekonomik “M....”, arkëtimin e shumës 71,764 lekë, të përfituar tepër për punime të pakryera në tenderin me objekt “*Shtrim me beton i rrugës Ali Halili, fshati Halil*”.

Brenda muajit Korrik 2015

A. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për Nëpunësin Civil” dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tij si dhe mbështetur në kreun IV, neni 11, germa” e” dhe “ç dhe neni 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kontratës individuale të punës, i kemi kërkuar Kryetarit të Bashkisë Fushë - Krujë, fillimin e procedurave e masave disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Largim nga detyra**” dhe për punonjësit me kontratë, nga “**Vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**” si më poshtë:

1. **Z. R. T**, me detyrë Zv/kryetar i Bashkisë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;
2. **Z. A. D**, me detyrë inxhinier ndërtimi, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

3. Znj. L.N., me detyrë inspektore e licencimit, në cilësinë e Anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

4. Znj. A.H., me detyrë juriste, në cilësinë e Anëtares së Njesisë së Prokurimit **5. Z. I.K.**, me detyrë inxhinier arkitekt, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit;

6. Z. M.D., me detyrë Përgjegjëse i Sektorit të Burimeve Njerëzore, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;

kanë vepruar në kundërshtim, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” gjatë realizimit të procedurave të prokurimit: për “Sistemim-asfaltim i rrugës së fshatit Zallë”, me fond limit 3,443,206 lekë, për “Sistemim-asfaltim i rrugës së Senevë, Arrameras”, me fond limit 3,768,323 lekë, për “Sistemim-asfaltim i rrugës së fshatit Halil”, me fond limit 3,261,863 lekë, për “Ndërtim KUZ lagje Dibranëve, Kameras”, me fond limit 2,691,757 lekë, për “Sistemim-asfaltim i rrugës së Vinjollëve e Danëve”, me fond limit 4,340,942 lekë, dhe për “Blerje karburanti naftë D1 për vitin 2014” me fond limit 1,083,333 lekë.

7. Znj. N.Ll me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të AMT, në cilësinë e Anëtares së Njesisë së Prokurimit;

8. Z. L.M., me detyrë specialist, në cilësinë e Anëtarit të Njesisë së Prokurimit ;

kanë vepruar në kundërshtim, me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” gjatë realizimit të procedurave të prokurimit: për “Rikonstruksion i rrugës së Durrësit”, me fond limit 111,704,062 lekë, për “Ndërtimi i shkollës së mesme “Shote Galica” Fushë Krujë”, me fond limit 139,836,446 lekë, për “Shtrim me beton i rrugës Ali Halili,” me fond limit 1,106,954 lekë dhe për “Pastrimit të qytetit Fushë Krujë për vitin 2014”, me fond limit 14,166,511 lekë.

9. Znj. Xh.Xh me detyrë Përgjegjëse i Sektorit të Financës për:

- mos zbatimin e plotë të rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm.

- hartimin dhe miratimin e buxhetit tej afateve ligjore dhe mos përfshirjen e detyrimeve debitoare dhe kreditore në buxhetin e vitit respektiv.

- mangësitë e konstatuara në dokumentimin e blerjeve dhe shërbimeve me vlera të vogla, në kundërshtim me Udhëzimin e APP nr. 2, datë 28.03.2013 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”.

- mos aplikimin e sanksioneve dhe penalteteve për ditë vonesa në zbatimin e detyrimeve kontraktore nga subjektet sipërmarrëse duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 296,623 lekë.

10. Z.E., me detyrë Drejtor i taksave dhe tarifave vendore,

11.Znj. L.P., me detyrë Inspektore kontrolli,

12. Z. Z.Gj., me detyrë Inspektor kontrolli,

13. Z. E.K., me detyrë Inspektor kontrolli, për:

- Planifikim të pasaktë për të ardhurat e taksave vendore të subjekteve të biznesit të vogël, të biznesit të madh, taksës së pastrimit, taksës së regjistrimit, taksës së popullatës, taksës së ndërtesës e pasurisë, taksës së pastrimit të popullatës, taksën e tokës bujqësore për vitin 2013-2014 dhe 2015 në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 12.

- Mos realizim të ardhura vendore të planifikuara në vitin 2013 në vlerën 27,565 mijë lekë, në vitin 2014 në vlerën 37,599 mijë lekë dhe për tremujorin e parë të vitit 2015 në vlerën 49,132 mijë lekë.

- Për subjektet debitorë, nuk disponohet një regjistër me të gjitha të dhënat dhe modalitetet për secilin subjekt debitor, nuk ka ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga 1904 subjekte prej vitit 2009 deri 31.12.2014 në vlerën **78,109 mijë lekë** në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenit 12 të tij, si dhe Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, *Kreu i XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve”*, pika 88 dhe pika 89.2, pika 89.3 dhe pika 96.

- Mos kryerje kontrolli vendosja e taksave subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë me qarkullim nën 2 milion lekë për 70 për qind të subjekteve “sa xhiro e një ambulanti”.

D. MASA ADMINISTRATIVE:

Nga Bashkia Fushë Krujë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16, t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të marrë masë administrative me gjobë për:**

1. Z. R. A, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1866, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve në objektin “Sistemim, asfaltim i rrugës së fshatit Zallë”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë në vlerën totale **220,020 lekë pa T.V.SH**, e cila përfaqëson pagesa të përfituara nga subjekti “V.....” për punime të pakryera, veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. Z. G.K, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1686/1,

3. Z. Edison Drishti, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve, me licencë MK 0249/4, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve në objektin “Zgjerim e rikonstruksion i rrugës Larushk i Poshtëm + Sistemim, Asfaltim Lagje Lata, Loci, Zogu e Luka”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë në vlerën totale **1,438,029 lekë pa T.V.SH**, e cila përfaqëson pagesa të përfituara nga subjekti “G.....” për punime të pakryera, veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

4. Z. E.N, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1846/3, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve në objektin “Sistemim, asfaltim i rrugës së Çamit, Myftarit dhe Avdi Zirit”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë në vlerën totale **56,322 lekë pa T.V.SH**, e cila përfaqëson pagesa të përfituara nga subjekti “V....” për punime të pakryera, veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

5. Z. Bashkim Mata, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, me licencë MK 1127/1, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të punimeve në objektin “Shtrim me beton i rrugës Ali Halili, fshati Halil”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë në vlerën totale **59,803 lekë pa T.V.SH**, e cila përfaqëson pagesa të përfituara nga subjekti “M....” për punime të pakryera, veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Nga Bashkia Fushë Krujë, me shkresë nr. 1205/8, prot, datë 16.06.2015, protokolluar në KLSH, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar plotësisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit shtetëror Bashkim Harizi, abdulla Duka dhe Luan Kuka, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT